

**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM GJIROKASTËR**



ANALIZA VJETORE 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM GJIROKASTËR

ANALIZA VJETORE E
GJYKATËS SË SHKALLËS TË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM GJIROKASTËR
PËR VITIN 2024

Dokumenti Analiza Vjetore e Gjykatës përfaqëson në mënyrë të përmblëdhur analizën e punës së kryer dhe performancën e Gjykatës së Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër gjatë vitit kalendarik 2024 dhe njëkohësisht parashtrohet problematikat e konstatuara gjatë këtij viti përpara i takon funksionimit të institucionit në tërësi si dhe sfidat për të ardhmen.

I. VEPRIMTARIA GJYQËSORE

1. Ngarkesa dhe lloji i çështjeve gjyqësore.
2. Tendenca e ngarkesës me çështje.
3. Likuidimi/përfundimi i çështjeve.
 - a. Çështjet penale themeli.
 - b. Kërkesa penale.
 - c. Kërkesa penale në seancë paraprake.
 - d. Çështjet civile.
 - e. Kërkesat civile (çështje civile pa palë kundërshtare)
4. Ngarkesa me çështje për gjyqtar.
 - a. Delegimet e gjyqtarëve.
5. Shpejtësia në gjykim.
6. Heqja dorë nga gjykimi i çështjeve.
7. Përfundimi i gjyqtarit nga gjykimi i çështjes.
8. Kërkesa e gjyqtarit për plotësimin e trupit gjykues në çështje

II. MENAXHIMI I LËVIZJES SË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

1. Mbikqyrja e progresit të çështjeve.

III. MENAXHIMI ADMINISTRATIV I GJYKATËS

1. Organika dhe burimet njerëzore.
2. Teknologjia e informacionit.
3. Çështjet e ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë.
4. Kryesekretaria dhe ofrimi i shërbimeve nga administrata gjyqësore.
5. Aksesit, transparenca, marrëdhëniet me publikun dhe median.
6. Administrimi i fondeve publike.
7. Marrëdhëniet me institucionet e tjera.

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

HYRJE

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, ushtron funksionin e saj në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit Nr. 98/2016, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Kjo gjykatë, për vitin kalendarik 2024, është përpjekur të plotësojë me korrektësi dhe cilësi detyrat që i ngarkon ligji për të ushtruar veprimtarinë gjyqësore në funksion të dhënies së drejtësisë.

Në raportin analizues të përpiluar do të trajtojmë me hollësi veprimtarinë gjyqësore në tërësi, të gjyqtarëve në veçanti, arritjet dhe përmirësimet që duhet të bëhen për vitin 2025.

Të dhënat e trajtuara në këtë analizë janë marrë nga të dhënat statistikore që disponon Kryesekretaria, si dhe të dhënat që dërgohen në Ministrinë e Drejtësisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër me qendër në Gjirokastër, e cila shtrin veprimtarinë në të 7-të bashkitë e Qarkut Gjirokastër (Bashkia Gjirokastër, Libohovë, Dropull, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë) ka në organikën e saj 7 gjyqtarë.

Fillimi i vitit 2024 e gjeti gjykatën me 4 gjyqtarë si më poshtë:

- Suela Dashi (e cila me vendimin me nr.170, datë 03.04.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar me transferim të përkohshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës),
- Marjola Beluli (e cila me vendimin me nr.476, datë 31.07.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar me transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës),
- Entela Selmanaj (e cila prej datës 08.10.2024 ushtron funksionin e Zëvendëskryetares pranë kësaj gjykate),
- Nertila Përallaj.

Pas transferimit të dy gjyqtareve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, trupa gjyqësore e kësaj gjykate, në një pjesë të madhe të vitit kalendarik 2024, ka qenë e përbërë vetëm prej dy gjyqtareve Entela Selmanaj dhe Nertila Përallaj dhe ngarkesa e punës ka qenë tepër e lartë.

Në muajin tetor e në vijim, përbërja e trupës gjyqësore në këtë gjykatë, pas emërimit të dy magistratëve të reja, ka qenë si më poshtë:

- Entela Selmanaj (Zëvendëskryetare)
- Nertila Përallaj
- Ermira Bushi (emëruar me vendimin nr. 576, datë 02.10.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor)
- Orinda Lloshi (emëruar me vendimin nr. 581, datë 02.10.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor)

Për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve, gjykata nuk është e ndarë në dhoma civile/penale. Gjyqtarët kanë gjykuar çështje penale, civile, kërkesat paraprake si dhe çështjet penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale, në mbështetje të nenit 282 të Kodit të Drejtësisë Penale për

të Mitur, të miratuar edhe me ligjin nr.37/2017 dhe Udhëzimit nr.79 datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në fokus të punës së gjykatës ka qenë ofrimi i shërbimeve administrative në një kohë sa më të shpejtë, sigurimi i aksesit të vazhdueshëm dhe informimi i saktë dhe i shpejtë mbi veprimtarinë gjyqësore me qëllim rritjen e besimit të publikut.

I. VEPRIMTARIA GJYQËSORE

1. NGARKESA DHE LLOJI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE.

Gjatë vitit 2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër totali i çështjeve për shqyrtim ka qenë 3434 çështje (penale, penale - administrative, civile dhe familjare). Numri i çështjeve të mbartura nga viti 2023 është 1209, ndërsa çështje të reja të regjistruara në vitin 2024 janë 2225.


Nga totali i çështjeve për shqyrtim, për 2236 çështje ka përfunduar gjykimi në vitin 2024, ndërsa 1198 çështje kanë mbetur të papërfunduara dhe janë mbartur për gjykim në vitin 2025, sipas tabelës.

1.

Tabela.1

Ngarkesa e çështjeve për vitin 2024	Numri i çështjeve
Çështje të gjykuara (përfunduara)	2236
Çështje të mbartura nga viti 2024 në vitin 2025	1198
Çështje të regjistruara të reja në vitin 2024	2225

Grafiku.1



Nga totali i çështjeve të gjykuara rezulton se:

1. Në kategorinë penale, ka përfunduar gjykimi në total për 1521 çështje. Në këtë numër përfshihen çështje penale themeli, penale të veçanta, kërkesa penale-administrative, kërkesa penale gjatë hetimeve paraprake, në seancë paraprake dhe kërkesa penale gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit.
2. Në kategorinë civile ka përfunduar gjykimi në total për 715 çështje, nga të cilat:

- a) Familjare me palë kundërshtare ka përfunduar gjykimi për 250 çështje
- b) Familjare pa palë kundërshtare ka përfunduar gjykimi për 25 çështje
- c) Marrëdhënie pune ka përfunduar gjykimi për 30 çështje
- d) Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare ka përfunduar gjykimi për 200 çështje
- e) Civile të përgjithshme me palë kundërshtare ka përfunduar gjykimi 210 çështje.

Nga analiza e të dhënave të mësipërme, referuar organikës në fakt rezultojnë 4 (katër) gjyqtar për 3-mujorin e parë të vitit 2024, 3 (tre) gjyqtar për 3-mujorin e dytë, 2 (dy) gjyqtarë për 3-mujorin e tretë, ku është përballuar një ngarkesë e madhe çështjes gjyqësore, ndërsa në 3-mujorin e katërt janë emëruar dy gjyqtare, magjistratë të rinj, duke e çuar sërish numrin në 4 (katër) gjyqtar.

Numri i çështjeve penale është i lartë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, pasi Prokuroria përbëhet nga 7 (shtatë) prokuror që ushtrojnë detyrën dhe kjo gjykatë mbulon kërkesat e të dënuarve në IEVP-Tepelenë, si dhe kërkesat e personave nën hetim.


2. TENDENCA E NGARKESËS ME ÇËSHTJE.

Për të parë tendencën e ngarkesës, le ti referohemi tabelës 2 të çështjeve për 5 (pesë) vitet e fundit, duke bërë edhe krahasimet përkatëse:


Tabela.2

Viti	Çështje të regjistruara për gjykim	Çështje të gjykuara	Çështje të mbartura
2020	3145	2246	899
2021	3041	2215	826
2022	2267	1611	656
2023	2625	2252	1209
2024	2225	2236	1198

Grafiku.2



Grafiku.3




Raporti i numrit të çështjeve të regjistruara në total (përfshirë të mbartura nga viti paraardhës) në 5 (pesë) vitet e fundit:

Tabela. 3

Çështje të regjistruara në total (penale dhe civile)				
Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
3145	3041	2267	2625	2225

Grafiku.4



Numri i çështjeve të gjykuara në 5 (pesë) vitet e fundit:


Tabela.4

Çështje të gjykuara në total (penale dhe civile)				
Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
2246	2215	1611	2252	2236

Të dhënat statistikore për ngarkesën e çështjeve në 5 (pesë) vitet e fundit, tregojnë se në vitin 2024 krahasuar me vitet paraardhëse treguesit janë të përafërt, me përjashtim të vitit 2022, ku numri i çështjeve të gjykuara është më i ulët se vitet e tjera, kjo si rrjedhojë e ndryshimeve në gjykatë nga procesi i vettingut.

Për vitin 2024, duke pasur parasysh edhe numrin e gjyqtarëve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjrokastrë (në pjesën më të madhe të vitit 2024 kanë qenë vetëm dy gjyqtarë), këto tregues janë të lartë.

Grafiku.5



3. LIKUJDIMI/PËRFUNDIMI I ÇËSHTJEVE.


Numri i çështjeve të mbartura në fund të vitit, për vitin pasardhës, në pesë vitet e fundit:

Tabela.5

Çështje të mbartura në fund të vitit, për vitin pasardhës (penale dhe civile)				
Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
899	826	656	1209	1198

Nga analiza e të dhënave statistikore të mësipërme rezulton se, në fund të vitit 2024, numri i çështjeve të mbartura për vitin 2025 është pothuajse në të njëjtat shifra me vitin paraardhës, ndërsa për periudhën 2020-2021 vihet re një rritje progresive. Numri i çështjeve të mbartura në vitin 2025 lidhet me numrin e ulët të gjyqtarëve në këtë gjykatë gjatë vitit 2024, për shkak të transferimeve dhe rritjen e ngarkesës individuale të gjyqtarëve të mbetur.

Grafiku.6




Në tabelën vijuese, pasqyrohen të dhënat e numrit të çështjeve penale dhe civile, të papërfunduara në fund të vitit 2024:

Tabela.6

Lloji i çështjeve të mbartura	Numri i çështjeve të papërfunduara në fund të vitit 2024
Civile	797
Penale	401
Totali	1198

Grafiku.7



Norma e zgjidhjes/likuidimit të çështjeve “*Clearance rate*”, (që është raporti i thjeshtë i dalë nga pjesëtimi ndërmjet çështjeve të zgjidhura me çështjet e reja të regjistruara brenda një periudhe vjetore, e shprehur në përqindje), në vitin 2024 është 100.5 %.

- Norma e zgjidhjes së çështjeve tregon nëse gjykata ka qenë e aftë të zgjidhë më shumë çështje se sa janë regjistruar për shqyrtim dhe për rrjedhim nëse edhe një pjesë e çështjeve të mbartura nga viti i mëparshëm janë zgjidhur.

Norma e likuidimit mbi 100.5 % është tregues për likuidimin e çështjeve si gjykatë. Vlera 100.5 % e *Clearance rate* për vitin 2024 sigurisht që konsiderohet pozitive.

Në fakt, konstatohet që norma e likuidimit të çështjeve penale është më e lartë se norma e likuidimit të çështjeve civile, përkatësisht 110 % dhe 85 %.

Megjithëse mesatarja e kësaj norme mund të konsiderohet e lartë (100.5 %), nevojitet kujdes në menaxhim më aktiv në qarkullimin e çështjeve civile, ku vlera *Clearance rate* është 85%, çka do të thotë se, gjatë vitit 2024 kanë përfunduar më pak çështje nga sa janë regjistruar.

Gjithsesi, duke patur parasysh edhe ngarkesën me çështje të regjistruara të reja në vitin 2024, si dhe largimin edhe të dy gjyqtarëve gjatë vitit 2024, në lidhje me situatën e krijuar në gjykatë, ky tregues mbetet i lartë.

➤ Për të gjitha çështjet e shqyrtuara në gjykatë në vitin 2024, norma e përfundimit/likuidimit të çështjeve “*Clearance rate*” është **100.5 %**.

$$\text{Clearance rate}_{total} = \frac{2236 \text{ [numri i çështjeve të gjykuara]}}{2225 \text{ [numri i çështjeve të reja për 2024]}} \times 100\% = 100.5 \%$$

- Për çështjet e natyrës penale, norma e përfundimit/likuidimit të çështjeve “*Clearance rate*” është **110 %**

$$\text{Clearance rate}_{\text{penale}} = \frac{1521 \text{ [numri i çështjeve të gjykuara]}}{1386 \text{ [numri i çështjeve të reja për 2024]}} \times 100 \% = 110 \%$$

- Për çështjet e natyrës civile, norma e përfundimit/likuidimit të çështjeve “*Clearance rate*” është **85 %**

$$\text{Clearance rate}_{\text{civile}} = \frac{715 \text{ [numri i çështjeve të gjykuara]}}{839 \text{ [numri i çështjeve të reja për 2024]}} \times 100\% = 85 \%$$


a. Çështje penale themeli.

Nga 1521 çështje të gjykuara të natyrës penale, rezulton se 113 raste janë krime, 968 çështje janë kundërvajtje penale, ndërsa 440 janë çështje penale administrative.

Tabela.7

Nr.	Natyra e çështjeve	Numri i çështjeve në vitin 2021	Numri i çështjeve në vitin 2022	Numri i çështjeve në vitin 2023	Numri i çështjeve në vitin 2024
1	Penale themeli krime	302	391	1076	113
2	Kërkesa penale, kërkesa administrative-penale etj.	876	420	408	968

Grafiku.8




Nga çështjet e gjykuara në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës në çështjet e natyrës penale themeli, rezulton se gjatë vitit 2024, janë dënuar në total 259 persona, përfshirë 10 persona të mitur në konflikt me ligjin.

Për 18 persona gjykata ka dhënë vendim pafajësie, ndërsa për 6 persona gjykata ka vendosur pushimin e çështjes penale.

Tabela.8

Vendimmarrja në penale themeli	Viti 2024
Të dënuar	259
Të pafajshëm	18
Pushimin e çështjes	6
Totali i personave të gjykuar	283

Grafiku.9



Gjatë vitit 2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër janë gjykuar 10 të mitur në konflikt me ligjin. Në mbështetje të nenit 282 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur të miratuar me ligjin nr.37/2017, në zbatim të Udhëzimit nr.79 datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktimin e gjyqtarëve, për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale” të gjithë gjyqtarët kanë gjykuar çështje penale me të mitur, në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale.

Në tabelën nr. 9, po paraqesim të dhëna lidhur me administrimin e çështjeve penale për vitin 2024, të kategorizuara sipas llojit të çështjes, si dhe mënyra e disponimit për çështjet e gjykuara: me vendim themeli apo me lloje të tjera disponimi.

Tabela.9

	Lloji i çështjes	ADMINISTRIMI I ÇËSHTJEVE				
		Në pritje të gjykit në fillim të periudhës	Çështje të reja të paraqitura në gjykatë	Çështje të gjykuara		
				Çështje të gjykuara gjithsej	Me vendim në themel	Me lloje të tjera disponimi
A.	Krime	176	141	113	113	0
A.1	Vrasje me dashje (Neni 76,77,78,78/a,79, 79/a,79/b,79/c,81,82,83)	1	0	0	0	0
A.2	Vjedhje (neni 139, 140, 141)	40	70	60	60	0
A.3	Dhuna në familje	15	50	40	40	0
A.4	Krime të kryera nga ose ndaj të miturve	0	8	6	6	0
B.	Kundërvajtje penale	339	760	968	953	15
B.1	Kundërvajtje penale të kryera nga ose ndaj të miturve	0	6	4	4	0
C.	Çështje penale administrative	21	485	440	422	18
C.1	Masa sigurimi	0	403	398	398	0
C.2	Lirim me kusht	12	4	16	10	6
C.3	Ekstradime	3	2	5	5	0
D.	Çështje të ligjit Antimafia	0	0	0	0	0
E.	Çështje penale gjithsej (A+B+C+D)	536	1386	1521	1488	33

Ndërkohë numri i personave të dënuar për krime gjatë vitit 2024 është 189, ndërsa numri i personave të dënuar për kundërvajtje penale është 70. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka shpallur të pafajshëm 18 persona dhe për 6 persona është vendosur: Pushim Procedimi Penal.

Gjatë vitit 2024 nuk rezulton të jetë dënuar asnjë person me burgim të përjetshëm. Ndërkohë, numri i personave të dënuar, masa e aplikuar e dënimit ka qenë: a) me gjobë 67 raste, b) deri në 2 vjet burgim 148 raste, c) 2-5 vjet burgim 35 raste, ç) 5-10 vjet 6 raste. Siç vihet re, dënimi më i aplikuar nga gjykata është dënimi me burgim deri në 2 vjet, i cili referuar të dhënave statistikore për figurat e veprave penale, përputhet me rrezikshmërinë e ulët të veprave penale më të përhapura. Për vitin 2024, bie në sy aplikimi i nenit 59 dhe 63 i K. Penal, si dënime alternative në 3 raste, duke pezulluar dënimin me burgim dhe vënien në provë, i ndjekur nga kryerja e një pune me interes publik pa shpërblim.

Zbatimi i alternativave të dënimit me burgim dhe i procedurave të reja për zgjidhjen e çështjeve penale është prioritet i gjykatës gjithashtu.

Nën domosdoshmërinë për përmbushjen e qëllimeve që dënimi penal duhet të ketë në individualizimin e dënimeve janë mbajtur parasysh këto parime:

- Parimi i propocionalitetit
- Parimi i humanizmit
- Parimi i drejtësisë restauruese.

Zakonisht, për autorët e mitur, për të sëmuret, të moshuarit, për autorët jo përsëritës specialë apo të përgjithshëm, për autoret femra dhe për vepra penale me rrezikshmëri konkrete të ulët, janë aplikuar në masë dënimet alternative. Nga dënimet alternative, më shumë është aplikuar pezullimi i ekzekutimit të dënimit dhe vënia në provë sipas nenit 59 të K. Penal, duke u vendosur shpesh edhe detyrimi për të dënuarin sipas nenit 60 të K. Penal. Në raste të caktuara është aplikuar edhe neni 63 i Kodit Penal, i cili për autorët e veprave penale, ka patur avantazhin e rehabilitimit të shpejtë, çka është vlerësuar nisur nga prognoza pozitive për sjelljen e tyre në të ardhmen.

Dënimet alternative nuk janë zbatuar në rastet kur autori ka qenë përsëritës, kur veprat kanë patur një rrezikshmëri konkrete të konsiderueshme dhe në prani të rrethanave rënduese.

➤ **Kriminaliteti sipas përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre**


Nisur nga të dhënat e mësipërme rezulton se kriminaliteti në Qarkun Gjirokastrë, kryesisht karakterizohet nga veprat penale me rrezikshmëri të ulët. Në një këndvështrim të përgjithshëm veprat penale më të përhapura dhe të regjistruara gjatë vitit 2024 kanë qenë:

- **Veprat penale kundër rendit, sigurisë publike dhe autoritetit të shtetit** gjithsej **333** procedime nga të cilat **9** procedime për "Kultivim të bimëve narkotike", parashikuar nga neni 284 i K.Penal, **26** procedime për "Prodhim dhe shitje të narkotikëve", parashikuar nga neni 283 i K.Penal, **27** procedime për "Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor" parashikuar nga neni 290 i K.Penal, **97** procedime për veprën penale "Drejtimi automjeteve në mënyrë të parregullt " parashikuar nga neni 291 i K.Penal, **6** procedime për nenet 278, 278/a, 279, 280 të K.Penal, **16** procedime për nenin 298 të K.Penal, **143** procedime për nenin 297 të K.Penal dhe **9** procedime për nenin 287 të K.Penal etj,
- **Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike** gjithsej **174** procedime ku numrin më të madh e zënë ato të parashikuara nga neni **134** i Kodit Penal (vjedhje pasurisë) me **87** procedime të regjistruara, për nenin 137 i Kodit Penal (Vjedhje energjisë elektrike) **10** procedime, (veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve) **22** procedime, për nenet 150-162 (shkatërrimi i pronës) **42** procedime, neni 143 i Kodit Penal (mashtrimi) **13** procedime.
- **Krimet kundër jetës dhe shëndetit**, gjithsej **58** procedime, përkatësisht, **2** procedime penale për nenin 79/dh të Kodit Penal, **1** procedim penal për nenin 78 të Kodit Penal, **1** procedim penal për nenin 76 të Kodit Penal, **4** procedime për nenin 88 të Kodit Penal, **19** procedime penale për nenin 89 të Kodit Penal, **31** procedime penale për vepra penale kundër familjes të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal dhe **1** procedim penal për nenin 90 të Kodit Penal.

- **Veprat penale kundër drejtësisë** gjithsej **16** procedime të regjistruara përkatësisht, **6** procedime penale për nenin 323 të Kodit Penal, **3** procedime penale për nenin 320 të Kodit Penal, **2** procedime penale për nenin 305 të Kodit Penal dhe nga **1** procedim penal për nenet 321, 306, 301, 302 dhe 309 të Kodit Penal.
- **Krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetëror** gjithsej **23** procedime, përkatësisht **20** procedime penale për nenin 248 të Kodit Penal, **2** procedime penale për nenin 250 të Kodit Penal dhe **1** procedim penal për nenin 257/a të Kodit Penal kundër një ish-gjyqtari të shkarkuar nga vetingu.
- **Krimet në fushën e falsifikimit të dokumentave** gjithsej **16** procedime penale, përkatësisht **11** procedime për nenin 186 të Kodit Penal, **2** procedime për nenin 186/a/1 të Kodit Penal, **3** procedime për nenin 190/1 të Kodit Penal dhe **1** procedim për nenin 191/1 të Kodit Penal.
- **Krimet në fushën doganore** gjithsej **29** procedime penale, përkatësisht **14** procedime për nenin 179/a të Kodit Penal, **8** procedime për nenin 174 të Kodit Penal, **3** procedime për nenin 178/1 të Kodit Penal dhe **1** procedim penal për nenet 171, 172, 173, 175 të Kodit Penal.

Veprat penale krahasuar me vitin **2023**, paraqiten në grafikun krahasimor, si mëposhtë:

Grafiku.10



Në krahasim me vitin 2023, gjatë vitit raportues 2024 kemi një tendencë në ulje të veprave penale të "Kultivimit të bimëve narkotike" dhe "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit", një rritje të lehtë të ngjarjeve me vjedhje dhe dyfishim të rasteve të shkatërrimit të pronës dhe kalimit të paligjshëm të kufirit. Veprat e tjera kanë përgjithësisht të njëjtat vlera.

Shqetësues për vitin 2024 është fakti se numri i rasteve të dhunës në familje, ka një rritje krahasuar me vitin 2023. Vërehet se viktimat e dhunës në familje në një numër të konsiderueshëm rastesh kërkojnë urdhër mbrojtje, por jo ndjekje penale.

Rrethi Gjyqësor Gjirokastrë përfshin Bashkinë Gjirokastrë, Tepelenë, Libohovë, Dropull, Memaliaj, Përmet dhe Këlcyrë me një sipërfaqe prej 1954 km². Relievi i territorit që përfshin ky rreth gjyqësor është kryesisht malor, por ka edhe terren fushor e kodrinor, kryesisht në luginat e lumenjve Vjosë e Drino. Në skajin jug- lindor, ky rreth gjyqësor kufizohet me shtetin grek. Duke qenë rreth kufitar, ka dy pika të kalimit kufitar të ngritura me marrëveshje ndërmjet dy shteteve, Pika e Kalimit Kufitar Kakavijë dhe Pika e Kalimit Kufitar Tre-Urat Çarçovë Përmet.

Ky rreth gjyqësor karakterizohet nga një shkallë urbanizimi mesatar, pasi ka zona të thella ku nuk ka rrugë automobilistike të asfaltuara dhe mund të qarkullohet me vështirësi. Ky faktor ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik e shoqëror të komuniteteve që banojnë në ato zona.

Lëvizjet demografike në Qarkun e Gjirokastrës, kanë qenë të shumta kryesisht në drejtim të emigrimit në shtete të tjera dhe gjithashtu edhe migrimit nga këto zona drejt kryeqytetit dhe më pak drejt qyteteve të tjera. Po kështu, lëvizje janë shoqëruar nga komunitetet lokale rurale, drejt qendrave urbane në këtë rreth gjyqësor, kryesisht në qytetin e Gjirokastrës e më pak në qytetet e tjera.

Tipar i popullsisë janë elementë etnografike të përbashkëta, por edhe specifika dalluese sipas zonave. Në këtë rreth ka edhe një komunitet që i përket minoritetit grek, i shtrirë kryesisht përgjatë kufirit me shtetin grek. Lëvizjet migratore brenda këtij rrethi gjyqësor, kanë sjellë heterogjenizimin e komuniteteve lokale tradicionale, në një masë të konsiderueshme.


I përmendëm këto karakteristika kryesore, pasi mendojmë se ato ndikojnë drejtpërdrejt jo vetëm në strukturën e kriminalitetit në këtë rreth gjyqësor, por disa prej tyre edhe në veprimtarinë e organeve ligjzbatuese.

Në tabelën 10 pasqyrohen llojet e dënimeve të dhëna nga gjykata:

Tabela.10

Dënimi	Numri i personave të dënuar në vitin 2024
Me gjobë	67
Burgim deri në dy vjet.	148
Burgim nga 2 deri në 5 vjet.	35
Burgim nga 5 deri në 10 vjet.	6
Aplikimi i nenit 59	3
Total	259

Grafiku.11



Rezulton që numri i personave të dënuar gjatë vitit 2024 është 259 persona. Gjatë vitit 2024 nuk rezulton të jetë dënuar asnjë person me burgim të përjetshëm. Në vitin 2024 numri i personave të dënuar me gjobë është në të njëjtat nivele krahasuar me një vit më parë. Për të dyja vitet, dënimi më i aplikuar nga gjykata është dënimi me burgim deri në 2 vjet, i cili referuar të dhënave statistikore për figurat e veprave penale, përputhet me rrezikshmërinë e ulët të veprave penale më të përhapura. Nëse nisemi nga analiza e të dhënave të vitit 2024 rezulton se, numri i çështjeve që janë shqyrtuar me gjykim të shkurtuar, si dhe gjykimi i drejtpërdrejtë janë aplikuar në pak raste. Me ndryshimet në ligjin nr. 35/2017 të Kodit të Procedurës Penale janë shtuar edhe lloje të tjera të gjykimeve të posaçme si, Urdhëri penal dhe Marrëveshja për pranimin e fajësisë, por numri i këtyre gjykimeve është i ulët.

b. Kërkesat penale.


Gjatë vitit 2024 janë gjykuar 440 çështje të natyrës kërkesa penale dhe kërkesa penale-administrative, ku përfshihen kërkesat në fazën e hetimeve paraprake si vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi personal, lejim përgjimi etj. (398 raste), kërkesa në fazën e ekzekutimit të dënimit, si ulje dënimi, lirim para kohe me kusht (16 raste), aplikim të dënimeve alternative, kërkesa për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë si kërkesa për njohje të vendimeve të gjykatave të huaja, kërkesë për ekstradim (5 raste), etj. Rezulton se masat e sigurimit më të aplikuara nga gjykata janë ato “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” dhe “arrest në burg”. Në disa raste, masat e sigurimit personal të karakterit shtrëngues janë caktuar së bashku me masa të tjera shtrënguese si “Ndalim i daljes jashtë shtetit”.

Tabela.11

Natyra e çështjes	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Kërkesa penale	302	462	541	440

Duke krahasuar të dhënat statistikore të vitit 2024 me vitet paraardhës, vërehet një ulje e numrit të kërkesave penale.

Grafiku.12



c. Kërkesat penale në seancë paraprake.

Gjykata në vitin 2024 ka shqyrtuar 578 kërkesa penale në seancë paraprake.

Nga verifikimi i të dhënave në lidhje me procedimet penale të ardhura nga Prokuroria ka rezultuar se:

- 312 çështje me objekt: “Dërgim në Gjyq”
- 135 çështje me objekt: “Kërkesë për pushimin e gjykimit”
- 131 të tjera


Pas ndryshimeve në ligjin nr.35/2017 në Kodin e Procedurës Penale, numri i kërkesave të seancës paraprake si kërkesa penale për dërgimin e çështjes në gjyq dhe kërkesa për pushimin e çështjes penale për krime, vazhdon të jetë i lartë, me një rritje progresive, krahasuar me vitet paraardhës.

Në vitin 2024 janë shqyrtuar gjithsej për 578 kërkesa të seancës paraprake, të cilat kanë përfunduar me të dhënat si mëposhtë: 179 janë pranuar, 135 janë pushuar, 133 kanë kaluar për gjykim, 41 janë kthyer për vazhdimin e hetimeve, 18 moskompetencë me tregues sipas tabelës së mëposhtme. Periudha e gjykimit për këtë kategori çështjesh përgjithësisht ka qenë 30 ditë.

Tabela.12

MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË KËRKESAVE PENALE					
Pranuar	Pushuar	Kaluar për gjykim	Kthim për plotësim hetimesh	Vendosur Moskompetenca	Përfunduar
179	135	133	41	18	578

Grafiku.13



d. Çështjet civile:

Gjatë vitit 2024, përsa i përket çështjeve civile janë mbartur 673 çështje nga viti 2023, janë regjistruar 839 çështje të reja dhe janë gjykuar gjithsej 715 çështje.

Në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, pjesa dërmuese e çështjeve të gjykuara në vitin 2024 janë gjykuar me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar.

Nga analiza e të dhënave statistikore konstatohet një numër prej 119 çështje civile të pushuara gjatë vitit 2024, shifër kjo e njëjtë me vitin paraardhës.

Gjithsesi, numri i çështjeve civile të pushuara mbetet në nivel të ulët dhe lidhet me mosndërgjegjësimin për plotësimin e elementëve të padisë, mosparaqitja e paditësit/kërkuesit pa shkaqe të arsyeshme dhe tërheqja nga gjykimi i padisë/kërkesës. Rastet e padisë që nuk mund të ngrihet janë të pakta.

Në zbatim edhe të vendimit nr.554, datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”, çështjet e pushuara dhe çështjet për të cilat është vendosur “Kthim Akte”, kur janë paraqitur përsëri për shqyrtim në gjykatë, i kanë kaluar automatikisht të njëjtit gjyqtar që i ka pushuar më parë.


Disa nga llojet më të përhapura të çështjeve të natyrës civile të gjykuara gjatë vitit 2024 paraqiten si vijon:

Tabela.13


Lloji i çështjes	Numri i çështjeve në vitin 2022	Numri i çështjeve në vitin 2023	Numri i çështjeve në vitin 2024
Padi për marrëdhënie pune	14	28	25
Të tjera kontraktuale	30	56	31
Vërtetim fakti juridik	33	267	137

Familjare	129	303	20
Lëshim urdhër ekzekutimi	211	298	125
Urdhra të menjëhershëm të mbrojtjes	29	39	75

Grafiku.14



Grafiku.15




Nga analiza e të dhënave të mësipërme rezulton se edhe për vitin 2024 ngarkesa më e lartë është në çështjet me objekt “Vërtetimi fakti juridik” (137 çështje) dhe pas tyre renditen kërkesat me objekt “Lëshimi i urdhër ekzekutimi” (125 çështje).

Përsa i përket urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, numri i përgjithshëm i tyre për vitin 2024 është 75 raste. Nga të dhënat e vitit 2024 rezulton se kanë kërkuar lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes 75 shtetas/e. Pothuaj të gjitha kërkesat për urdhër mbrojtje janë përcjellë/paraqitur nga ana e Komisarivateve të Policisë në bazë të formularëve të plotësuar nga paditësit.

Tabela.14

Lloji i çështjes civile	Total	Pranuar	Pushuar	Refuzuar
Urdhër i menjëhershëm mbrojtje	75	35	25	15

Grafiku.16



Nga analiza e të dhënave vërehet se numri i rasteve të refuzimit është më i vogël se numri i rasteve kur gjykata ka pranuar “Lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes”. Shkaqet e refuzimit të kërkesës për lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes lidhen me mosvërtetimin e ushtrimit të dhunës dhe marrëdhënies familjare sipas përcaktimit në ligj, por konstatohet edhe një numër i lartë i rasteve të pushimit. Shkaqet e pushimit janë mosparaqitja e viktimës së dhunës në familje në seancë pa shkaqe.

Praktika mbizotëruese është ajo e shqyrtimit të kërkesës për urdhër të menjëhershëm të mbrojtjes edhe në rast të mosparaqitjes në seancë apo tërheqjes së viktimës së dhunës në familje kur janë përcjellë/paraqitur nga ana e Komisarivateve të Policisë.


e. Kërkesat civile (çështje civile pa palë kundërshtare)

Tabela.15


Lloji kërkesave civile pa palë kundërshtare	Numri i kërkesave në vitin 2022	Numri i kërkesave në vitin 2023	Numri i kërkesave në vitin 2024
Lëshimi i urdhërit të ekzekutimit	201	298	125
Vërtetim fakti i vjetërsisë në punë	33	267	137
Lëshim autorizimi për të miturin	6	3	2

Nga analiza e të dhënave rezulton se ngarkesa më e lartë për vitin 2024 është me kërkesat për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, ku mbizotërojnë kërkesat për tituj ekzekutivë si kontratat e kredisë bankare. Nga viti 2023 në vitin 2024 konstatohet një ulje e numrit të kërkesave për vërtetimin e faktit të vjetërsisë në punë nga ana e shtetasve që kërkojnë përfitimin e të drejtës për pension, për shkak të ndryshimeve ligjore në lidhje me Vendimin nr.00-21556, datë 07.05.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Grafiku.17



Grafiku.18



4. NGARKESA ME ÇËSHTJE PËR GJYQTAR.

Aktualisht trupa gjyqësorë nuk është e plotësuar me 7 gjyqtarë sikurse janë në organikë. Në fillim të vitit 2024, gjykimet bëheshin nga 4 gjyqtarë 1. Suela Dashi (e cila me vendimin me nr.170, datë 03.04.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar me transferim të përkohshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës), 2. Marjola Beluli (e cila me vendimin me nr.476, datë 31.07.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar me transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës) 3. Entela Selmanaj (e cila prej datës 08.10.2024 ushtron funksionin e Zëvendëskryetares pranë kësaj gjykate) dhe 4. Nertila Përallaj. Pas transferimit të dy gjyqtareve, në muajin Tetor 2024 u emëruan 2 magjistrat të rinj: Orinda Lloshi (emëruar me vendimin nr. 581, datë 02.10.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ermira Bushi (emëruar me vendimin nr. 576, datë 02.10.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor).


Të dhënat statistikore për ngarkesën e çdo gjyqtari të Gjykatës së Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjrokastrë gjatë vitin 2024 sipas numrit të çështjeve të gjykuara janë:

Tabela.16

Emër, Mbiemër	Çështje të gjykuara	Penale		Civile		Delegime		Kërkesa Penale	Kërkesa Civile
		I vetëm dhe kryesues	Trup Gjykues	I vetëm dhe kryesues	Trup Gjykues	Penale	Civile		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Entela Selmanaj	694	200	0	250	0	0	0	150	94
Nertila Përallaj	768	200	0	200	0	0	0	270	98
Ermira Bushi	49	20	0	9	0	0	0	10	10
Orinda Lloshi	54	25	0	20	0	0	0	5	4
Marjola Beluli	503	100	0	150	0	0	0	123	130
Suela Dashi	161	40	0	80	0	0	0	20	21
Të deleguar									
Dajana Ndreja	1	1	0	0	0	0	0	0	0
Fatmir Ndreu	1	1	0	0	0	0	0	0	0
Gladiola Bregu	1	1	0	0	0	0	0	0	0
Rudi Laze	1	1	0	0	0	0	0	0	0
Dritan Hasani	1	1	0	0	0	0	0	0	0
Yrfet Shkreli	2	1	0	1	0	0	0	0	0
TOTAL	2236	591	0	710	0	0	0	578	357

Në vijim është paraqitja grafike e shpërndarjes së numrit të çështjeve të përfunduara gjatë vitit 2024.

Grafiku.19



Nga analiza e të dhënave evidentohet fakti se ngarkesa e gjyqtarëve me çështje plotëson parametrat e vendosura në vendimin e KLGJ-së për kriteret matëse të vlerësimit të veprimtarisë së gjyqtarëve.

Bazuar në një llogaritje mesatare të ngarkesës për gjyqtar, duke pjestuar numrin total të çështjeve të regjistruara, 3434 çështje në vitin 2024 me numrin e gjyqtarëve të gjykatës (4), rezulton një numër mesatar prej 859 çështje për gjyqtar. Ky tregues nxjerr në pah ngarkesën e lartë në punë për gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Gjatë vitit 2024 janë regjistruar në total 2225 çështje të reja dhe kanë përfunduar 2236 çështje.

Raporti mbi numrin e çështjeve për çdo gjyqtar (Case for Judge), llogaritur duke pjesëtuar numrin total të çështjeve të regjistruara në vitin 2024 me numrin e gjyqtarëve të gjykatës:

$$\frac{2225 \text{ [totali i numrit të çështjeve të regjistruara]}}{4 \text{ [numri i anëtarëve të gjykatës në vitin 2024]}} = 556 \text{ çështje të reja për gjyqtar}$$

Ndërsa numri i çështjeve të gjykuara për çdo gjyqtar rezulton si më poshtë:

$$\frac{2252 \text{ [totali i numrit të çështjeve të gjykuara]}}{4 \text{ [numri i anëtarëve të gjykatës në vitin 2024]}} = 559 \text{ çështje për gjyqtar}$$

Ngarkesa e lartë e gjyqtarëve (ka ndikuar në afatin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore), por gjithsesi nuk është tejkaluar afati 30 ditë i përcaktuar sipas raportimit pranë KLGJ si dhe përgjithësisht janë respektuar afatet ligjore të arsyetimit të vendimeve.

a. Delegimet e gjyqtarëve

Gjatë vitit 2024, gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, përgjithësisht nuk kanë qenë të deleguar për të gjykuar çështje në gjykata të tjera, si në Sarandë etj. Ndërkohë për nevoja të Gjykatës së Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër kanë qenë të deleguar në këtë gjykatë 6 gjyqtarë, nga gjykatat e tjera, për gjykimin e 1 çështje civile dhe 6 çështjeve penale, të cilat kanë përfunduar në vitin 2024.

Megjithëse ndryshimet në K.Pr.Civile dhe K.Pr.Penale që kanë sjellë rënien e numrit të çështjeve që gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, delegimet mbeten domosdoshmëri për shkak të konsumimit të trupave gjykues si pasojë e vendimmarrjes së mëparshme të tyre në çështje të lidhura ose të konfliktit të interesit që mund të kenë patur gjyqtarët e gjykatës, si dhe numrit të vogël të gjyqtarëve të mbetur aktualisht në gjykatë. Ulja e numrit të çështjeve penale që gjykohen me trup gjykues prej tre antarësh, ka ardhur si rezultat i punës parandaluese dhe ndjekjes në vazhdimësi të veprimtarisë së paligjshme në fushën e kultivimit e trafikimit të bimëve narkotike, në parandalimin dhe goditjen e formave të trafikimit, si dhe reduktimit të veprave penale kundër personave apo pasurisë. Ka patur një situatë të përmirësuar edhe përsa i përket treguesve për veprën penale të kultivimit të bimëve narkotike, shifrat tregojnë një tendencë uljeje të këtij fenomeni.

Tabela. 17

Emër, Mbiemër	Çështje të gjykuara	Penale		Civile		Delegime		Kërkesa Penale	Kërkesa Civile
		I vetëm dhe kryesues	Trup Gjykues	I vetëm dhe kryesues	Trup Gjykues	Penale	Civile		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Të deleguar									
Dajana Ndreja	1	1	0	0	0	0	0	0	0
Fatmir Ndreu	1	1	0	0	0	0	0	0	0
Gladiola Bregu	1	1	0	0	0	0	0	0	0
Rudi Laze	1	1	0	0	0	0	0	0	0
TOTAL	4	4	0	0	0	0	0	0	0

5. SHPEJTËSIA NË GJYKIM SIPAS KATEGORISË SË ÇËSHTJEVE.

➤ Raporti i shpejtësisë së gjykimit të çështjeve në total, penale dhe civile

Nga totali i 2236 çështjeve të gjykuara rezulton se 2121 çështje janë përfunduar së gjykuari brenda afatit 1-6 muaj, 85 çështje në harkun kohor 7-12 muaj dhe 30 çështje në harkun kohor 1-2 vjet. Çështjet civile janë ato që rezultojnë më të shtrira në kohë përse i përket kohëzgjatjes së gjykimit, ndërkohë që çështjet penale të gjykuara gjatë vitit 2024 janë mbyllur të gjitha brenda periudhës së gjykimit 1-6 muaj.


Tabela.18

Kategoria e Çështjeve	ÇËSHTJE TË PËRFUNDUARA GJATË VITIT 2024		
	1-6 Muaj	7-12 Muaj	1-2 vjet
Civile të përgjithshme me palë kundërshtare	160	30	20
Familjare me palë kundërshtare	200	40	10
Marrëdhënie pune	15	15	0
Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare	200	0	0
Familjare pa palë kundërshtare	25	0	0
TOTALI CIVILE	600	85	30
Penale themeli (krime)	113	0	0
Penale themeli (kundërvajtje)	968	0	0
Kërkesa administrative penale	440	0	0
TOTALI PENALE	1521	0	0
TOTALI (CIVILE + PENALE)	2121	85	30

Më poshtë po paraqesim grafikisht edhe raportet e shpejtësisë të gjyimit për çështjet.


Raporti i shpejtësisë së gjyimit të çështjeve penale

Grafiku.20



Raporti i shpejtësisë së gjyimit të çështjeve civile

Grafiku.21



➤ Analizë mbi përmbushjen e standardeve kohore ndërkombëtare

Gjykata ka përcaktuar si objektiv të brendshëm, arritjen e respektimit të afateve të gjykimit të çështjeve sipas kategorisë më cilësore “A” të CEPEJ (Time Frames “A”). Nga statistikatat e mësipërme rezulton se janë përmbushur plotësisht afatet e gjykimit të çështjeve sipas kategorisë më cilësore “A” të CEPEJ (Time Frames “A”).

Konkretisht, për vitin 2024, 100 % e çështjeve penale nuk kanë zgjatur më shumë se 6 muaj. Gjithashtu përse i përket çështjeve penale në gjykim (të papërfunduara), për vitin 2024 nuk konstatohet të ketë çështje, të cilat e kanë kaluar afatin 1 vit.

Nga të dhënat statistikore për çështjet civile rezulton se vetëm 84 % e çështjeve të gjykuara është në kohëzgjatje gjykimi 1-6 muaj, 12% është në kohëzgjatje gjykimi 7-12 muaj, 4% është në kohëzgjatje gjykimi 1-2 vjet.

Gjykata ka përcaktuar si objektiv të brendshëm të saj, dhënien e përparësisë në gjykim të çështjeve tejet komplekse, me qëllim moskalimin e afatit 2 vjeçar të gjykimit, në respektim të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Shkaqet e tejkalimit të afatit 1-2 vjet janë kryesisht shkaqe ligjore që përjashtojnë përgjegjësinë për tejkalimin e afatit si:

- pezullimi i gjykimit deri në zgjidhjen e një çështje tjetër gjyqësore apo rastet e tjera të pezullimit të parashikuara në ligj;
- në gjykimet e pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme mosvazhdimi i gjykimit në fazën e dytë të pjesëtimit deri në marrjen formë të prerë të vendimit të gjykatës për fazën e parë të pjesëtimit;
- shkaqe objektive për zëvendësimin e gjyqtarëve të çështjes si heqje dorë, procesi i vetingut, kërkesa për përjashtim etj, për rrjedhim rifillimi i gjykimit, njëkohësisht me njoftimet me shpallje për palët, si dhe ekspertime.

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) është treguesi që krahason numrin total të çështjeve të pazgjidhura, në fund të periudhës së caktuar, me numrin e çështjeve të zgjidhura, brenda të njëjtës periudhë kohore, raport ky i konvertuar në numër ditësh.

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) për çështjet e natyrës penale është 96.2 ditë.

$$DT_{\text{Penale 2024}} = \frac{\text{Numri i çështjeve në pritje për gjykim në 31.12.2024}}{\text{Numri i çështjeve të zgjidhura në 2024}} \times 365 = \frac{401}{1512} \times 365 = 96.2$$

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) për çështjet e natyrës civile është 407 ditë.

$$DT_{\text{Civile 2024}} = \frac{\text{Numri i çështjeve në pritje për gjykim në 31.12.2024}}{\text{Numri i çështjeve të zgjidhura në 2024}} \times 365 = \frac{797}{715} \times 365 = 407$$

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) për të gjitha çështjet në total është 195.5 ditë.

$$DT_{2024} = \frac{\text{Numri i çështjeve në pritje për gjykim në 31.12.2024}}{\text{Numri i çështjeve të zgjidhura në 2024}} \times 365 = \frac{1198}{2236} \times 365 = 195.5$$


Për të krahasuar të dhënat dhe për të kuptuar më mirë ecurinë, po bëjmë tabelën dhe grafikun e tendencës për dyvjeçarin e fundit 2022-2024.

Për çështjet penale

Tabela.19

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin çështjeve penale (ditë)		
Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
253	131.8	96.2

Grafiku.22




Për çështjet civile

Tabela.20

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin çështjeve civile (ditë)		
Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
43	319.8	407

Grafiku.23




Të dhënat e mësipërme tregojnë mesataren e kohëzgjatjes në ditë të gjykrimeve për kategoritë e çështjeve penale dhe civile për vitet 2022, 2023, 2024. Nga krahasimi me vitin paraardhës, rezulton një ulje në kohëzgjatjen mesatare të gjykrimit në çështjet penale, nga 131 ditë në 96 ditë, ndërsa në çështjet civile vihet re një rritje në kohëzgjatjen mesatare të gjykrimit (kohën e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve) për shkak të lëvizjes, transferimeve të gjyqtarëve në gjykatat e tjera.

Përsa i përket kohës së nevojshme të përfundimit/likuidimit të çështjeve në total, rezulton se koha e nevojshme për likuidimin e të gjitha çështjeve, gjatë vitit 2024, në krahasim me vitin paraardhës është në të njëjtat vlera.

Tabela.21

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin çështjeve në total (ditë)		
Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
148.62	195.9	195.5

Grafiku.24




Të dhënat për numrin total të seancave gjyqësore të zhvilluara për vitin 2023 dhe 2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër paraqiten si më poshtë:

Tabela.22

Kategoria e çështjeve të gjykuara	Numri total i seancave gjyqësore	
	2023	2024
Çështje Civile	2484	3116
Çështje Penale	3237	3747

Grafiku.25




Përsa i përket të dhënave për kohëzgjatjen e gjykimeve në numër seancash për vitet 2023 dhe 2024 pasqyrohen në tabelën 23 dhe paraqiten grafikisht si mëposhtë:

Tabela.23

Kategoria e çështjeve të gjykuara	Mesatarja e numrit të seancave nga depozitimi në vendim për çështje	
	2023	2024
Çështje Civile	3	4
Çështje Penale	2	2

Grafiku.26



Sipas të dhënave, vlera 2 (dy) e mesatares së numrit të seancave për çështje penale është e njëjtë më vitin paraardhës. Për çështjet civile kemi një rritje të lehtë të treguesit mesatar të numrit të seancave, nga 3 seanca për çështje në vitin 2023, në 4 seanca për çështje në vitin 2024.

Në përgjithësi, nisur nga të dhënat e viteve të mëparshëm, shkaqet kryesore që sjellin rritjen e numrit të seancave jo efektive, por edhe kohëzgjatjes së gjykimit, vazhdojnë të jenë problematikat me njoftimet nëpërmjet shërbimit postar, por edhe nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore në çështjet penale, veçanërisht kur personi që thirret ndodhet jashtë territorit që përfshin Rrethin Gjyqësor Gjirokastrë. Problemet e njoftimit nëpërmjet shërbimit postar, vijnë kryesisht për shkak se punonjësit që ndryshohen shpesh, nuk janë të specializuar dhe veprojnë në kundërshtim me ligjin, përsa i përket plotësimit të të gjitha rubrikave në aktet e njoftimit, tregimit të lidhjes ndërmjet personit që merr përsipër njoftimin dhe personit të thirrur, etj., duke sjellë si pasojë shpalljen të pavlefshëm të njoftimit dhe shtyrjen e seancës për përsëritjen e tij (njoftimit). Ndërsa problemi i njoftimeve nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore lidhet kryesisht me mos kthimin në kohë të konfirmimit për kryerjen e njoftimit për datën dhe orën e seancës.

Për sa i përket kohëzgjatjes mesatare në ditë për çështje gjyqësore për vitin 2024, evidentohet një rritje e këtij treguesi për çështjet civile dhe një ulje për çështjet penale, por kjo është një dukuri e pritshme duke patur parasysh lëvizjen e gjyqtarëve në gjykata të tjera si dhe ngarkesën e çdo gjyqtari. Nga ana tjetër, fakti që çështjet zgjidhen me pak seanca, tregon efikasitetin e gjykimeve penale dhe civile gjatë periudhës dyvjeçare 2023-2024.

Faktorët e jashtëm që kanë ndikuar në shpejtësinë në gjykim janë mosparaqitja e palëve në gjykim, paraqitja e kërkesave për shtyrje të seancës, nisur nga pjesëmarrja në gjykim tjetër etj. Në disa raste palët ndërgjyqëse hasin vështirësi për të siguruar dhe paraqitur provat e caktuara të cilat ndodhen pranë institucioneve shtetërore dhe në disa raste vetë këto institucione përmbushin me vonesë urdhërat e gjykatës. Ndër faktorët e tjerë të brendshëm që ndikojnë në shpejtësinë e gjykimit mbeten,

sikurse në vitin e kaluar, ngarkesa e lartë në punë për secilin gjyqtar, referuar numrit mesatar të çështjeve për gjyqtar dhe organikës së gjykatës. Këto problematika kanë sjellë si domosdoshmëri një rol më aktiv të gjyqtarit për administrimin e procesit gjyqësor.


6. HEQJA DORË NGA GJYKIMI I ÇËSHTJES

Kërkesat për heqje dorë në vitin 2024 janë si në tabelën 24:

Tabela.24

Kërkesat për heqje dorë	Viti 2024
Pranim	13
Mospranim	7
Totali	20

Grafiku.27



Shkaqet kryesore të heqjes dorë nga gjykimi i çështjes edhe në vitin 2024 lidhen me pjesëmarrjen e gjyqtarëve në procese të tjera gjyqësore të lidhura apo vendimmarrje të mëparshme ku janë shprehur me vlerësime nga të cilat cënohet paanësia, kjo edhe për shkak të parashikimit në ligj të mos shqyrtimit të një çështje nga gjyqtari që më parë ka gjykuar një çështje tjetër të caktuar. Pjesa tjetër e rasteve të heqjes dorë nga gjykimi lidhet me vlerësimin e ekzistencës së arsyeve të tjera serioze të njëanshmërisë.

7. PËRJASHTIMI I GJYQTARIT NGA GJYKIMI I ÇËSHTJES (Me kërkesë të palëve)


Gjatë vitit 2024 janë paraqitur 15 kërkesa nga palët ndërgjyqëse për përjashtim gjyqtari nga gjykimi i çështjes, prej të cilave 8 në çështje civile (0 pranuar, 8 rrëzuar) dhe 7 në çështje penale (0 pranuar, 7 rrëzuar). Nga analiza e rasteve të shqyrtimit të kërkesave për përjashtimin e gjyqtarëve, vërehet se, shkak kryesor i pranimit të kërkesës për përjashtim është garantimi edhe në dukje i paanshmërisë së gjyqtarit. Ndërsa shkak kryesorë të rrëzimit të kërkesës për përjashtim janë: paraqitja nga pala kërkuese si shkak përjashtimi vendimmarrja e ndërmjetme e gjyqtarit, mosparaqitja e arsyeve të njëanshmërisë nga ato të parashikuara në ligj dhe mos depozitimi i akteve për të provuar ekzistencën e arsyeve të njëanshmërisë.

Krahasuar me të dhënat e viteve të mëparshme rezulton se ka një qëndrueshmëri të numrit të kërkesave për përjashtim gjyqtari në çështjet penale dhe në çështjet civile.

Tabela.25

Kërkesat për përjashtim	Viti 2024
Pranim	0
Mospranim	15
Totali	15

Grafik. 28



8. KËRKESA E GJYQTARIT PËR PLOTËSIMIN E TRUPIT GJYKUES NË ÇËSHTJE

Gjatë vitit 2024 janë paraqitur 17 kërkesa për plotësimin e trupit gjykues nga gjyqtari i çështjes, nga të cilat 14 raste janë plotësuar me gjyqtarë të Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, në 3 raste është kërkuar plotësimi i trupit gjykues me gjyqtar nga Këshilli

i Lartë Gjyqësor. Nga analiza e rasteve të shqyrtimit të kërkesave për plotësimin e trupave gjykues me gjyqtarë, vërehet se, shkak kryesor i këtyre kërkesave është klasifikimi i veprës penale sipas parashikimeve të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

II. MENAXHIMI I LËVIZJES TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

1. Mbikqyrja e progresit të çështjeve.

- Në vazhdimësi gjatë vitit 2024 ka patur bashkëpunim dhe mbështetje nga drejtuesi i Prokurorisë, Dhoma Vendore e Avokatisë Gjirokastër, për implementimin e masave që lidheshin me reduktimin e kërkesave për shtyrje, konkretizimin dhe bazueshmërinë e tyre në prova, si dhe një planifikim më të mirë të gjykimit, kryerja e veprimeve procedurale brenda një afati të caktuar etj.
- Edhe me institucionet vendore si Drejtoria e Policisë Gjirokastër, IEVP Tepelenë, Zyra Postare Gjirokastër, ka vazhduar bashkëpunimi për masat e ndërmarra në kuadër të planit të veprimit siç janë: paraqitja e dokumentave të kërkuara përpara seancës, komunikimi i shpejtë me gjykatën edhe në rrugë elektronike, përmirësimi i mënyrës së kryerjes së njoftimeve, aplikimi i mënyrave alternative të njoftimit dhe komunikimit si p.sh me rrugë elektronike nëpërmjet komunikimit me adresën zyrtare të emailit rethigjirokaster@gjykata.gov.al.
- Gjykata ka aplikuar komunikimin elektronik me e-mail me palet ndergjyqese, avokatët apo pale pjesëmarrëse në proces si ekspertët, psikologët etj. si dhe ka përmirësuar përmbajtjen e njoftimeve me qëllim njoftimin në të njëjtën kohë të palëve edhe me të drejtat dhe detyrimet e tyre, si për t'u mbrojtur me avokat para se të fillojë procesi gjyqësor, për të paraqitur prova etj. Po ashtu është kërkuar bashkëpunimi i të gjitha institucioneve vendore për komunikimin në rrugë zyrtare elektronike në një afat sa më të shpejtë nëpërmjet adresës elektronike zyrtare dhe bashkëpunimi me njësitë vendore dhe Bashkitë lidhur me përmirësimin dhe konfirmimin në kohë të njoftimit me shpallje.

III. MENAXHIMI ADMINISTRATIV I GJYKATËS

1. Organika dhe burimet njerëzore.

Me vendimin e KLGJ, Nr. 150, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi,” është miratuar dhe përcaktuar Struktura organizative e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër e cila përbëhet nga:

- a. Kryetari;
- b. Trupa gjyqësore;
- c. Kancelari;
- d. Kryesekretari;
- e. Sekretaria Gjyqësore;
- f. Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar;

- g. Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve;
- h. Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave, Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë;
- i. Sektori i Protokollit, Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit

➤ **Shërbimet administrative realizohen nga këto struktura:**

- a. Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar;
- b. Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve;
- c. Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, e Median;
- d. Sektori i Protokollit dhe Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit.

Strukturat e shërbimeve administrative janë përgjegjëse për mirëfunksionimin e veprimtarive administrative të gjykatës. Ato kryejnë detyrat e ngarkuara nga organet vendimmarrëse sipas rregullores dhe sipas përkrahjeve të punës, të miratuara nga Këshilli i Gjykatës.

Nëpunësit civilë gjyqësorë të strukturave administrative, emërohen dhe shkarkohen nga Këshilli i Gjykatës, sipas ligjit.

➤ **Shërbimet gjyqësore realizohen nga këto struktura:**

- a. Kryesekretari;
- b. Sekretari gjyqësor.

Strukturat e shërbimeve gjyqësore mbështesin drejtpërdrejt veprimtarinë gjyqësore të gjykatës. Ato kryejnë detyrat e ngarkuara sipas përkrahjeve të punës të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Gjykatës.

➤ **Shërbimet mbështetëse** sigurojnë ruajtjen, kujdesin dhe mirëmbajtjen e mjediseve të gjykatës, si dhe garantimin e ushtrimit të funksioneve gjyqësore dhe administrative.

Shërbimet mbështetëse ushtrohen nga nëpunës civilë gjyqësorë, që kryejnë detyrat sipas përkrahjeve të punës bashkëlidhur kësaj rregullore dhe atyre të miratuara nga Këshilli i Gjykatës, si dhe nga punonjës të tjerë gjyqësorë që emërohen dhe shkarkohen nga Kancelari dhe marrëdhëniet e punës së tyre rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.


Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve është përgjegjës për:

- krijimin, administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit të dosjes individuale për nëpunësit civilë gjyqësorë, si dhe punonjësit e tjerë të gjykatës;
- ndjekjen dhe zbatimin me përpikëri të legjislacionit në fushën e prokurimeve publike;
- kryerjen e shërbimeve të njoftimeve, dhënien ndihmë trupës gjyqësore dhe çdo veprimtarie tjetër që ka të bëjë me rregullin, sigurinë, shërbimet e transportit, mirëmbajtjen e mjediseve të gjykatës.

Punonjësit kanë të krijuar dosjen personale me të dhënat e personelit, pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve në Gjykatë.

Figura.1

ORGANIGRAMA E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM GJIROKASTËR



2. Teknologjia e informacionit.

Përgjatë vitit 2024 nga nëpunësi i IT-së janë kryer mirëmbajtje të infrastrukturës IT, duke përfshirë sistemet operative, mjetet e sigurisë, aplikacionet, bazat e të dhënave, serverat, sistemet e postës elektronike (e-mail), desktop, softuerin dhe harduerin. Është koordinuar puna me administratën mbi kërkesat dhe nevojat për të patur një qasje sa më eficiente në sistemet IT. Janë kryer upgrade të sistemeve operative dhe aplikacioneve përkatëse, janë instaluar patch-e të nevojshme me qëllim testimin e performancës së sistemeve dhe garantimin e funksionalitetit optimal përgjatë punës. Përgjithësisht, performanca e sistemeve ka qenë në nivele të mira, duke mos u bërë shkak për ndërprerje të proceseve gjyqësore.

Është dhënë asistencë e nevojshme dhe e shpejtë administratës në rastet e problematikave të dala rishtazi duke marrë masat për minimizimin e tyre. Është bashkëpunuar me Drejtorinë e IT dhe Menaxhimit të Çështjeve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe kompanitë përgjegjëse që ofrojnë shërbim zhvillimi dhe mirëmbajtje të sistemit ICMIS dhe RDA audio.

Infrastruktura ekzistuese e teknologjisë së informacionit në gjykatë ka përballuar rritjen e trafikut dhe ka pasur kapacitet të mjaftueshëm për të përmbushur nevojat aktuale të gjykatës. Megjithatë, është e nevojshme një përmirësim i vazhdueshëm për të përballuar rritjen e pritshme të nevojave dhe për t'u përshtatur me ndryshimet teknologjike, nevoja që i janë paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe me PBA 2025 – 2027 mbi investime në sektorin IT.

Gjatë vitit 2024 në të 5 sallat e gjyqimit ka nisur ndryshimi gradual i infrastrukturës, kjo edhe në kuadër të teknologjisë së re audio/audiovizuale të implementuar, megjithatë jemi akoma në proces. Po ashtu, gjykata tani më ka edhe një server të ri, në të cili është instaluar Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve, Kalendari elektronik PAKS+ dhe aplikacioni Infopoint Kiosk, si dhe një server storage,

në të cilin ruhen regjistrimet audio\audiovizuale të seancave gjyqësore dhe me programin e instaluar Backup Chain Software, bëhet backupi ditor i këtyre të dhënave nga storage lokal drejt serverit qendror në KLGJ.

Pajisjet kompjuterike me të cilat punojnë gjyqtarët dhe administrata gjyqësore janë pajisje me sisteme operative Windows 10 dhe 11 të licensuar si dhe me paketë Microsoft Office 2016 të licensuar.

Përsa i përket sigurisë kibernetike, ruajtja dhe mbrojtja e të dhënave digjitale gjyqësore është një prioritet i rëndësishëm. Nga analiza e riskut është vlerësuar se përgjatë vitit 2024 nuk ka patur thyerje të sigurisë së sistemeve apo humbje të të dhënave. Referuar dhe direktivave të KLGJ-së janë realizuar dhe marrë masat e nevojshme për kryerjen e backup-ve, sipas plan backup-eve respektive për secilin sistem. Janë zbatuar edhe politikat për të mbrojtur integritetin dhe privatësinë e të dhënave, janë ndarë rolet dhe të drejtat e përpunimit të të dhënave për secilin përdorues. Kompjuterat e përdorur nga përdoruesit fundor përditësohen periodikisht dhe si pjesë e group domain-it të gjykatës janë pjesë e politikave mbrojtëse të tij.

Në kuadër të përmirësimit të sigurisë për sistemet e teknologjisë së infomacionit, gjatë viti 2024 sipas udhëzimeve dhe asistencës së Drejtorisë së IT dhe Menaxhimit të Çështjeve në KLGJ është instaluar Antivirusi Trellix endpoint security në të gjitha pajisjet kompjuterike dhe servera në gjykatë.

Po ashtu është implementuar shërbimit 2 factor authentication (MFA) nëpërmjet platformës DUO Security për të gjithë përdoruesit e postës elektronike zyrtare në gjykatë, me qëllim rritjen e sigurisë në përdorimin të këtij shërbimi.

➤ Sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS

Gjykata ka në funksion sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, ICMIS, që prej vitit 2014, i cili përdoret për regjistrimin e çështjeve gjyqësore, hedhjen e çështjeve në çdo rast në short elektronik, mbajtjen e procesverbaleve të seancave gjyqësore, hedhjen e vendimeve dhe publikimin e vendimeve të anonimizuar në portal. Pjesa e anonimizimit të vendimeve të publikuara në portal, pas instalimit të versionit të përditësuar të ICMIS në Janar të vitit 2021, nuk kryet më manualisht prej sekretareve gjyqësore pasi realizohet automatikisht nga vetë sistemi.

Sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve ICMIS mundëson përveç të tjerash ndarjen e çështjeve ndërmjet gjyqtarëve, me short elektronik. Kërkesat e vendimit nr. 554, datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore” dhe vendimit nr. 724, datë 07.12.2023 “Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore” të Këshillit të Lartë të Gjyqësor janë respektuar në mënyrë rigorozë në lidhje me ndarjen e çështjeve me short si dhe është rritur transparenca e këtij procesi, duke u publikuar paraprakisht koha e realizimit të shortit, duke u garantuar pjesëmarrja e publikut si dhe nëpërmjet publikimit të listës së shortit. Nëpërmjet përcaktimit të vendit dhe orës së zhvillimit të shortit, në sallën gjyqësore nr.4 të Gjykatës, të pajisur me monitor, është rritur aksesit nga pjesëmarrës të tjerë të interesuar si palët, avokatët mbrojtës, media. Shorti i ditës, publikohet brenda 24-orëve në faqen web të gjykatës.

Nga të dhënat statistikore rezulton se çështjet janë shpërndarë në mënyrë përafërsisht të barabartë për të gjithë gjyqtarët. Diferencat justifikohen duke patur parasysh numrin e çështjeve të regjistruara gjatë gatishmërisë së secilit gjyqtar, që mund të ketë qenë jo i barabartë. Për masat e sigurimit dhe kërkesat

gjatë hetimeve paraprake, nga Zv/Kryetari i Gjykatës në zbatim të kompetencave ligjore është bërë sistematikisht planifikimi i gatishmërisë të gjyqtarëve sipas grafikut për shqyrtimin e çështjeve të natyrës urgjente, si rregull për një kohë një javore sipas rendit alfabetik duke marrë për bazë mbiemrin e gjyqtarit.

Përgjatë vitit 2024 në bashkëpunim me KLGJ, janë kryer zhvillime të reja në sistem, në kuadër të ndyshimeve ligjore si dhe përmirësimin e funksionaliteteve bazë të sistemit ICMIS.

Përsa i përket problematikave teknike të konstatuara gjatë punës si në sistemin ICMIS ashtu dhe në portalin www.gjykata.gov.al, është raportuar në platformën e suportit të kompanisë Kreatx dhe zgjidhja ka ardhur brenda afateve të kërkuara.

➤ Sistemi i regjistrimit audio të seancave gjyqësore RDA

Në kuadër të rritjes së parametrave shpejtësi, përgjegjësi dhe transparencë, në këtë gjykatë ka filluar që prej datës 01.05.2014 të aplikohet sistemi audio rekorder i mbajtjes së seancave gjyqësore për të gjithë gjykimet, me përjashtim të seancave të zhvilluara në dhomë këshillimi për shkak të parashikimeve ligjore (përjashtim gjyqtari, caktim mase sigurimi, lejim ose vleftësim përgjimi) sistem i cili ka funksionuar normalisht gjatë vitit 2024. Gjatë vitit 2024 kanë funksionuar normalisht 5 salla gjykimi, të pajisur me kompjuter, mixer për regjistrimin audio, dhe monitorë TV (për rastet e seancave kur duhen të shfaqen video të dorëzuar si provë nga palët pjesëmarrëse).

Në kuadër të përditësimeve të këtij sistemi është implemetuar gjatë këtij viti në gjykatë, teknologjia audio/audiovizive në procesin gjyqësor. Në çdo sallë gjykimi është instaluar kjo teknologji, e cila në vetvete është një upgrade harduer dhe softuer i infrastrukturës aktuale të sistemit audio RDA, e cila mundëson regjistrimin audio dhe video të seancave gjyqësore dhe ruajtjen e tyre lokalisht në kompjuterin e sallës gjyqësore si dhe transferimin në kohë reale në storage-in lokal, të instaluar në ambientet e përshtatur si dhomë serveri në gjykatë. Në kompjuterat e përdoruesve të këtij sistemi (gjyqtar, sekretare gjyqësore, salla) janë instaluar edhe programet e përditësuara të paketës FTR (Versioni 7.1)

Referuar aplikacionit PAKS +, për vitin 2024, janë zhvilluar gjithsej 6667 seanca gjyqësore, nga të cilat 6109 janë zhvilluar me regjistrim audio, ndërsa 558 seanca janë zhvilluar në dhomë këshillimi pa sistem audio për shkak të parashikimeve ligjore. Po ashtu me Urdhër nr. 67, datë 13.10.2021 të Titullarit të Gjykatës, kërkesat civile me objekt : Lëshim urdhër ekzekutimi, të cilat shqyrtohen në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve përjashtohen nga shqyrtimi në RDA.


Pra, regjistrimi audio i seancave gjyqësore për vitin 2024 është 91.6 % e seancave të zhvilluara, çka pasqyron qëndrueshmërinë e përdorimit të teknologjisë audio nga ana e gjykatës.

Raporti për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio nga çdo gjyqtar në vitin 2024 i gjeneruar nga aplikacioni PAKS+ paraqitet në tabelën 26 :

Tabela.26

Nr.	Gjyqtari	Seanca të regjistruara audio (SA)	Seanca të paregjistruara (SP)	Gjithsej (TOT)	Në % (SA/TOT *100)
1.	ENTELE SELMANAJ	1922	164	2086	92.1 %
2.	NERTILA PËRALLAJ	2078	168	2246	92.5 %
3.	ERMIRA BUSHI	191	43	234	81.6 %
4.	ORINDA LLOSHI	124	33	157	78 %
5.	MARJOLA BELULI	1399	117	1516	92.3 %
6.	SUELA DASHI	395	33	428	92.3 %
	TOTAL	6109	558	6667	91.6 %

Grafiku.29



Gjatë vitin 2024, të gjithë palët pjesëmarrëse në një seancë gjyqësore, janë pajisur me CD e regjistrimeve audio, sa herë që kanë bërë kërkesë për të patur një të tillë. Në portalin e gjykatës është vendosur edhe suporti i duhur për përdoruesit e programit FTR, për të dëgjuar regjistrimet audio. Përdoruesit apo punonjësit janë udhëzuar për përdorimin e sistemit audio dhe kanë realizuar me sukses edhe transkriptimet e procesverbaleve të seancave edhe në rastet kur ai është kërkuar fjalë për fjalë, si dhe është zbatuar udhëzimi për proceduarat e dhënies së kopjeve të regjistrimeve audio për përdorim nga publiku.

Zbatimi i këtij sistemi ka treguar se ka rritur ndjeshëm transparencën e gjykimit dhe ka ndikuar ndjeshëm në respektimin e rregullave të etikës dhe solemnitetit në gjykim si për gjyqtarët dhe për palët e avokatët.

Çdo lloj problematike teknike e evidentuar gjatë punës në sistemin audio është raportuar dhe zgjidhur brenda afateve të kërkuara nga kompania e suportit Forsitek shpk.

- Po kështu, në bashkëpunim me projektin Just (USAID), duke filluar nga viti 2011, në Gjykatë është implementuar kalendari elektronik i planifikimit të seancave gjyqësore PAKS+, çka eviton përplasjet në përdorimin e sallave të gjykimit. Ky kalendar ka funksionuar normalisht dhe gjatë vitit 2024.

3. Çështjet e infrastrukturës, ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë.

Në vitin 2024 janë marrë masa për përmirësim në drejtim të sistemit të monitorimit të lëvizjeve në ambientet e brendshme të gjykatës. Gjithashtu janë marrë masa për monitorimin dhe mirëfunksionimin e sistemit të integruar për mbrojtjen nga zjarri, përmbytjet dhe rreziqe të tjera. Po ashtu janë hartuar rregullat për garantimin e rendit dhe sigurisë në gjykatë, të cilat janë miratuar nga Këshilli i gjykatës në Rregulloren "Për rregullat standarde të lëvizjes dhe sigurisë në gjykata".

Në ambientet e godinës janë instaluar sistemet e mëposhtme :

- Në derën hyrëse të administratës është vendosur sistemi i kontrollit të aksesit, ku çdo punonjës i brendshëm është i pajisur me karta të personalizuar nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit për identifikimin e secilit prej tyre në sistem.
- Në derën e publikut është vendosur një pajisje kontrolli statike (detektor metalik Kalim Zone), si dhe punonjësi i sigurisë është i pajisur me një detektor metalik dore.
- Sistemi i kamerave të sigurisë kryen monitorimin e ambjenteve të brendshme dhe përreth godinës, të vendosura në zbatim të Udhëzimit nr.3, datë 05.03.2010 i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për "Sistemin e Video Survejimit në Ndërtesa, Lokale e Ambjente të Ndryshme", i ndryshuar.
- Sistemi i alarmit për zjarrin me një rrjet sensorësh të instaluar në çdo zyrë dhe në çdo ambient tjetër të godinës, i cili sinjalizon në çdo rast kur detekton temperaturë të lartë dhe shfaq në panelin qendror vendndodhjen e sensorit që sinjalizon alarmin.

Kushteve e godinës së gjykatës garantojnë plotësisht elementët e sigurisë përsa i përket lëvizjes së veçantë të gjyqtarëve e të palëve.

4. Kryesekretaria dhe ofrimi i shërbimeve nga administrata gjyqësore.

- Kjo zyrë gjatë gjithë vitit, ka funksionuar me kryesekretaren, e cila është mbështetur edhe nga Kancelari. Kancelari, veç detyrave të tij në organizmin dhe drejtimin e administratës gjyqësore ka përpiluar edhe raportet statistikore periodike dhe vjetore sipas modeleve të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe ndjekjen dhe kthimin e përgjigjes për çdo informacion të kërkuar.

- Detyrat e kryesekretares e cila është ngarkuar dhe ka kryer, pranimin e padive dhe të gjitha kërkesave të tjera që janë paraqitur për proceset gjyqësore, regjistrimin në regjistrat manual dhe sistemin elektronik ICMIS, shpërndarjen e dosjeve gjyqësore pas procesit të shortit të gjyqtarët dhe numërtimin e çështjeve.
- Kryesekretaria veç organizimit të zyrës ka trajtuar dosjet që nga dorëzimi i dosjeve në sekretari pas përfundimit deri në arkivimin e tyre, si kontrolli i dosjes fizike në momentin e dorëzimit, njoftimet pranimi i ankimeve, dhënien formë të prerë vendimeve, përcjelljen e dosjeve në gjykatat më të larta, përpunimin e tyre pas kthimit, përgatitja dhe përcjellja e vendimeve institucioneve përkatëse sipas urdhërimeve të gjykatës apo përcaktimeve ligjore dhe përcjella në fund e dosjeve në arkivin e gjykatës.
- Gjatë këtij viti është përmirësuar puna në aspektin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, në lidhje me këto element:
 - për pranimin e kërkesë-padive apo kërkesave të ndryshme,
 - marrjen e identitetit dhe adresave të sakta të palëve,
 - marrjen e miratimit për njoftimin elektronik,
 - kopjeve të padive me aktet shoqëruese sa janë palët,
 - për parapagimin e shpenzimeve gjyqësore etj.
- Gjatë vitit 2024 janë depozituar gjithsej (397 ankime, nga te cilat 167 raste janë ankime civile si dhe 230 raste janë ankime për çështje penale) mbi bazën e të cilave janë përpunuar, përcjellë dosjet në gjykatat më të larta, si dhe janë kryer veprimet përkatëse pas kthimit të çështjeve nga shqyrtimi në gjykatat më të larta. Në përgjithësi dosjet janë përpunuar dhe përcjellë në kohë dhe nuk ka pasur ankesa nga palët. Përcjellja e dosjeve që kanë rekurs direkt nga Gjykata e Apelit ka sjellë një lehtësim të punës në sekretarinë gjyqësore.
- Në lidhje me realizimin e objektivave gjatë vitit 2024, duke qenë se dhe kuadri ligjor tashmë është më i plotë janë ndërmarrë masat e duhura për:
 - Inventarizimin e dokumentacionit gjyqësor/administrative,
 - Përpunimin të dokumentacionit arkivor.
- Por nuk është bërë i mundur transferimi i dosjeve gjyqësore pranë Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor pasi nuk është miratuar kërkesa e bërë nga ana e specialistit të Arkivit për tërheqjen e fondit arkivor të vitit 2012 me argumentin se duhet të realizohet procesi i asgjësimit të dokumentacionit të përkohshëm, që ka humbur vlerën e ruajtjes deri në vitin 2011.
- Veprimtaria në këtë sektor, në lidhje me shërbimet e dokumenteve arkivore është krye me saktësi, në një kohë të shpejtë dhe brenda afateve ligjore, sipas të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për punën me dokumentet zyrtare në Republikën e Shqipërisë si: “Ligji për Arkivat”, Ligji 98/2016 për “Organizimin dhe Funksonimin e Pushtetit Gjyqësor”, Vendimi nr.426, datë 14.10.2022 i Këshillit të Lartë Gjyqësor për “Miratimin e listave tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata”, Rregullore nr.202 Prot., datë 15.05.2023 “Mbi metodikën e punës arkivore të fondkrijuesve të Sistemit të Drejtësisë”. Nga ana e specialistit të Arkivit është informuar dhe raportuar në kohë për problematikat ekzistuese dhe të mundshme në lidhje me kushtet e ruajtjes së fondit arkivor, përpunimit tekniko-shkencor të dokumentacionit

arkivor gjyqësor/administrativ si dhe masat që duhet të merren për realizimin e detyrave sipas përcaktimeve ligjore për Arkivat. Në lidhje me shfrytëzimin e dosjeve gjyqësore janë shërbyer një numër i konsiderueshëm dokumentesh të njësuara në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në përgjigje të kërkesave të adresuara në drejtim të gjykatës.

Janë vendosur në dispozicion të gjyqtarëve dosjet gjyqësore për llogari të gjykimit, janë shërbyer sipas afateve procedurale kopjet e akteve gjyqësore për personat e interesuar, avokatët si dhe institucionet shtetërore dhe jo shtetërore.

Në zbatim të kontratës nr.2552/15 me objekt: “Program digjitalizimi i arkivave të gjykatave”, të lidhur midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe palës kontraktuese “PC STORE” është vënë në dispozicion dokumentacioni arkivor gjyqësor (kodekset, regjistrat, aktet e protokollit) të inventarizuar për të realizuar procesin e skanimit.

- Bazuar edhe në rekomandimet/sugjerimet e ASHSGJ-së mbetet për t’u realizuar sistemi mbrojtës kundër zjarrit, raftet metalike dhe kutitë e kartonit për mbajtjen e dosjeve të kësaj gjykate. Përparësi në lidhje me vijueshmërinë e punës duhet të ketë asgjesimi dhe RHK sipas standardeve arkivore.
- Përsa i përket Zyrës së Shërbimeve Përmet (pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet) që prej muajit Maj 2023 e në vijim, veprimtaria e nëpunësve gjyqësorë, në lidhje me ofrimin e shërbimeve ndaj personave të interesuar, avokatët etj ka qenë e saktë dhe në një kohë të shpejtë. Korrekt dhe i shpejtë ka qenë bashkëpunimi i kësaj Zyre edhe me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër për dërgimin e dokumentacionit apo dhënien e informacionit.
- Gjatë 2024 ka patur një numër të konsiderueshëm kërkesash për shërbim nga arkiva. Gjithashtu janë duke u kryer edhe evidentimi i dosjeve për procedurat e asgjesimit. Është përcaktuar me Bashkinë Gjirokastër, vendi ku do të asgjesohen dokumentacioni gjyqësor, dosje që ju ka kaluar afati i ruajtjes (1050 gjithsej) për periudhën kohore 1952 - 1978. Problematikë vijon të mbetet mungesa e hapësirave të nevojshme për sistemimin dhe inventarizimin e dosjeve arkivore në ambientet e arkivës. Për këtë qëllim është i nevojshëm shtimi i ambienteve dhe i rafteve metalikë.

5. Aksesi, transparenca, marrëdhëniet me publikun dhe median.

- Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur, programi i transparencës për Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër. Nëpërmjet këtij programi përcaktohet korniza ligjore e veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ndërton dhe rrit transparencën në punën e saj institucionale. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, nëpërmjet pasqyrit të tij në faqen zyrtare të gjykatës Gjirokastër, pranë portalit www.gjykata.gov.al. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka marrë të gjitha masat për respektimin maksimal të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj, duke publikuar në faqen e saj elektronike zyrtare informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji, për publikim kryesisht nga autoriteti publik.

- Rezultoni se është kryer një punë e mirë për informimin dhe sensibilizimin e avokatëve, palëve ndërgjyqëse dhe qytetarëve për marrjen e informacionit mbi shortin dhe planifikimet e seancave gjyqësore nëpërmjet faqes elektronike zyrtare të gjykatës në internet.
- Në faqen zyrtare të gjykatës janë publikuar gjatë vitit 2024 njoftime se si mund të orientohemi në gjykatë, si të merret informacion mbi shortin dhe për kalendarin e seancave.
- Me qëllim rritjen e aksesit në drejtësi, është rritur numri i formularëve standart për kërkesa të ndryshme drejtuar gjykatës, Model Deklaratë Mbrojtje në procesin civil dhe akte të tjera të cilat ndihmojnë në veçanti palët e vetpërfaqësuar. Gjithashtu është arritur asistencë e personave me aftësi të kufizuar. Gjykata ka siguruar akses fizik nëpërmjet rampave të personave me aftësi të kufizuar në lëvizje, në hyrjen e gjykatës.
- Në prill të vitit 2020, me ndihmën e USAID, në ambjentet e hollit të gjykatës, është vendosur një infopoint, ku publiku mund të marrë informacion në kohë reale për çështjen për të cilën është i interesuar dhe shortin. Infopoint ka qenë funksional edhe gjatë vitit 2024.
- Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përditësuar programi i transparencës për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër, nëpërmjet pasqyrit të tij në portalin www.gjykata.gov.al.
- Gjykata ka publikuar në faqen e saj elektronike zyrtare informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji. Në kuadër të ligjit për të drejtën e informimit gjatë këtij viti janë trajtuar nga gjykata kërkesat për informim. Për të gjitha kërkesat, brenda afatit ligjor është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar pa çënuar të drejtat e tjera, siç është mbrojtja e të dhënave personale.
- Në raport me median, gjykata ka trajtuar kërkesat për informacione apo ndjekje të seancave gjyqësore për çështje për të cilat kanë patur interes publik. Në këto raste media apo gazetarët personalisht janë informuar me anë të njoftimeve. Për vitin 2024 është caktuar nga KLGJ gjyqtari i medias, Znj.Orinda Lloshi, e cila ushtron detyrën pranë kësaj Gjykate. Koordinimi me informacionet e kërkuara dhe të dhëna nga ana jonë është periodik dhe konform legjislacionit në fuqi.
- **Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**
 - Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median është bërë pjesë e strukturës dhe organikës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër, në qershor të vitit 2021. Kjo zyrë ushtron përgjegjësitë dhe kompetencat nga Specialisti i Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, në bashkëpunim me Drejtuesin e Institucionit, Kancelarin dhe Gjyqtarin e Medias. Mbështetur tek një nga parimet kryesore të punës sonë, atë të rritjes së besueshmërisë tek publiku, shërbimet e ofruara nga kjo zyrë, kanë qenë në përputhje dhe në respektim të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe Ligjit Nr. 9887, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

- Mbështetur në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me Nr. 454, datë 02.11.2022 “Për miratimin e Planit të Komunikimit për gjykatat”, është kordinuar puna me sektorët përkatës duke përmbushur detyrimet e parashikuara në vendim, në respekt të afateve kohore të parashikuara në formatin e përcaktuar. Organizimi i Javës së Drejtësisë është bërë në bazë të udhëzimeve të dhëna duke përmbushur objektivat dhe qëllimet për të vendosur ura komunikimi mes qytetarëve dhe institucionit tonë. Në këtë kuadër janë zhvilluar takime me drejtues të institucioneve lokale, të administratës vendore, me përfaqësues të zyrave dhe shërbimeve për të diskutuar në lidhje me rritjen e standarteve të bashkëpunimit dhe respektimin e kuadrit ligjor.
- Për të bërë të mundur sigurimin e aksesit për informacionin në masën më të madhe të mundshme, veç faqes zyrtare online janë hapur dhe funksionojnë edhe dy adresa të Gjykatës në platformat Facebook dhe LinkedIn.
- Bashkëpunimi me publikun dhe median është trajtuar me përparësi duke i dhënë rëndësinë e duhur, jo vetëm komunikimit të drejtpërdrejtë, por duke krijuar akses në gjykatë përmes; koordinimit me shërbimet e administratës së gjyqësorit, Kryesekretarisë, shërbimeve online në faqen zyrtare të gjykatës, adresës elektronike zyrtare (e-maili elektronik për kërkesat/ankesat), shërbimit postar për shkresat zyrtare /kërkesat për informacion). Në faqen zyrtare Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër disponon informacion të aksesueshëm dhe të përditësuar për publikun, median dhe palët e treta.
- Nëpërmjet kësaj zyre janë kryer të gjitha komunikimet me gazetarët e mediave kombëtare, lokale, si të medias vizive dhe të shtypit të shkruar. Informacioni i nevojshëm iu është dhënë gazetarëve në formë të shkruar në rastet, kur kërkimi i tyre është parashtruar me shkrim, në formatin elektronik, si dhe përmes shërbimit postar. E njëjta praktikë pune është ndjekur edhe në rastet kur informacioni është kërkuar nga përfaqësues të organizatave, shoqatave, rrjeteve sociale, studentë të Shkollës së Magjistraturës, qytetarë, të cilëve iu është ofruar në kohë materiali i kërkuar.
- Për vitin 2024 rezultojnë të regjistruara gjithsej **50** kërkesa në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, duke specifikuar se janë regjistruar ato kërkesa që kanë ardhur në respektim të nenit 11, të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, por pranë zyrës së Kryesekretarisë dhe përmes email-it zyrtar janë regjistruar një numër shumë herë më i madh shkresa/kërkesa që janë trajtuar në kohë nga zyrat përkatëse.
- Bashkëpunimi me gjyqtarin për median, ka qenë i shkëlqyer, duke kontribuar në mënyrë cilësore në trajtimin e kërkesave për informim.
- Duke qenë se Programi i Transparencës është vlerësuar si mjaft i rëndësishëm për veprimtarinë e gjykatës, perceptimin e drejtë të punës në këtë institucion, imazhin dhe mbështetjen e vlerave themelore të sistemit gjyqësor, i është kushtuar vëmendje çdo sugjerimi, kërkesë apo orientimi në funksion të përmirësimit të punës në këtë drejtim. Për vitin 2024 është ndjekur plani i komunikimit i miratuar nga K.L.Gj., i cili parashikon një qasje me frymë bashkëpunuese dhe lehtësuese për dhënien e informacionit për përdoruesit e Gjykatës.
- Sigurimi i një publiku dhe medie të informuar në një kohë sa më të shpejtë, mbetet një nga sfidat kryesore për Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median, pasi përmes informimit dhe vendosjes së komunikimit mund të ndryshojmë qasjen e publikut me gjyqësorin, gjyqtarëve me median, pakësimin e problematikave dhe rritjen e besueshmërisë në punën tonë.

6. Administrimi i fondeve publike për vitin 2024

Sipas Plan – Buxhetit të vitit 2024, Gjykata ka kryer shpenzimet për paga, sigurime Shoqërore, shpenzime operative dhe investime. Në shpenzimet e kryera janë pasur parasysh çeljet e fondeve sipas zërave të shpenzimeve.

Në fund të vitit është kryer rakordimi përfundimtar i shpenzimeve të vitit ushtrimor 2024, me Degën e Thesarit dhe është bërë raportimi i tyre në KLGJ.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendim nr. 146, datë 29.03.2023 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”, ka përcaktuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, 7 (shtatë) gjyqtarë dhe me Vendim nr. 151, datë 29.03.2023 “Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”, ka miratuar në total numrin e administratës gjyqësore në 32 (tridhjetë e dy), nga të cilët 20 nëpunës civilë gjyqësorë dhe 12 punonjës të tjerë gjyqësorë. Gjykata jonë ka shlyer të gjitha detyrimet për gjyqtarët periudha 01.01.2019 – 31.12.2022 brenda vitit buxhetor 2024 në masën 100%.

Në fund të vitit 2024 struktura organizative e gjykatës nga 39 punonjës plan, 36 në fakt, larguar nga vetingu (shkarkuar nga KPA 1 Gjyqtare) dhe nga administrata vakancë 1(një) pozicion pune K/Sekretare, 1 pozicion pune Specialist Prokurimesh.

ARTIKULLI 602 “Shpenzime Operative” në 000/lekë

Plani 8 000 mijë Plani i rishikuar 9 890 mijë. Fakti 9 890 mijë lekë. Realizimi në % 100%, kundrejt planit të rishikuar. Gjatë vitit 2024, në bashkëpunim me Departamentin e Monitorimit dhe Programimit të Buxhetit si dhe me Drejtorinë e Arkivit të Sistemit Gjyqësor u realizua përpunimi dhe transferimi i një pjesë të konsiderueshme të volumit të dosjeve për ruajtje të përhershme për në arkivin e sistemit gjyqësor, si dhe është një nga obligimet kryesore për periudhat në vazhdim, ulja e stokut të dosjeve nga arkiva e gjykatës dhe transferimi për në Arkivin e Sistemit Gjyqësor, për ruajtje të përhershme.

Në fund të vitit 2024 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka detyrime të palikujduara që i përkasin detyrimeve për muajin Dhjetor 2024 në masën si më poshtë:

- **Llogari të pagueshme.**

Tabela. 27

Nr	Emërtimi	Vlera
1	Llogari të Pagueshme	5 623 261
-	Detyrime për paga e sigurime	5 462 442
	Llog 421-paga	3 645 392
	Llog 431-tatim page	533 394
	Llog 435- sig shoqërore	926 660

	Llog 436- sig shëndetësore	159 765
	Llog 438- sig suplementar	80 976
	Furnitor (401)	277 074
	Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime SH.A Gjirokastrë	5 799
	ONE Telecommunications SHA Gjirokastrë.	4 295
	Posta Shqiptare SH.A	58 750
	FSHU (energji)	163 130
	Detyrim i trashëguar për llogarinë 401 nga Godina Përmet për servis fotokopje nga vite të kaluara	45 100
	Kreditorë për mjete në ruajtje (garancitë pasurore të të dënuarve)	10 063 941

Nga këto detyrime shuma 45 100 është sipas detyrim i prapambetur nga viti 2007, nga ish Gjykata Përmet, por në regjistrat e kontabilitet nuk ka dokumentacion justifikues dhe është i mbartur në vite, duke tejkaluar edhe afatet ligjore të parashkrimit.

Artikulli 606: “Transferi për buxhetet familjare dhe individë” në 000/lekë, Plani fillestar 0. Plani i rishikuar 234 mijë fakti 234 mijë lekë realizimi në % 100 %

Dhënie një pagë mujore për ish - sanitaren, punonjësen Antoneta Kosta me rastin e daljes në pension pleqërie, si dhe një pjesë për “Dhënie ndihme për punonjësit” në zbatim të akteve normative të Këshillit të Ministrave.

– Në zërin investime

Investimet janë kryer një pjesë nga të ardhurat e veta të gjykatës në vlerën 499 462 lekë dhe një pjesë tjetër në formën e “Grandeve në natyrë” Transferim kapital pa pagesë nga KLGJ.

Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë për vitin 2024, përveç disa aktive të reja transferim kapital pa pagesë nga KLGJ, u krye transferim kapital pa pagesë sipas vendimeve të KLGJ, (Lëvizjet brenda sistemit pa pagesë) edhe një pjesë e aktiveve nga ish Gjykata e Apelit Gjirokastrë, një pjesë e aktiveve nga ish Gjykata Përmet, si dhe një pjesë nga ish Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë në vlerën 42 532 535 lekë. Në zbatim të detyrave dhe rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit paisjet e transferuara u morën në dorëzim si Asete dhe janë paraqitur si Artikuj Afatgjatë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë. Ka përfunduar regjistrimi kontabël i këtyre artikujve dhe janë pasqyruar në Rregjistrin e Aktiveve të Gjykatës.

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 totali i Aktiveve Afatgjata me vlerën historike shkon 145 484 358 lekë. Aktivët afatshkurtra nga transferimet pa pagesë brenda sistemit janë marrë në dorëzim janë bërë hyrje në kontabilitet, dhe janë në vlerën 674 686 lekë.

– Të ardhurat

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër në ushtrimin e aktivitetit të saj, realizon të ardhura nga shitja e Pullave Tatimore dhe të ardhura nga 1% e kërkesë padive. Për vitin 2024 të ardhurat sipas zërave paraqiten si vijon:

Tabela.28

Nr	Emërtimi	Vlera
1	Të Ardhura shitje Pulla Tatimore	227 900
2	Të Ardhura nga 1% akt padi	275 225
	Totali	503 125

Sipas Akt-Rakordimit vjetor 31.12.2024 me Degën e Thesarit, pjesa që i takon institucionit nga këto të Ardhura është 10% e taksës së pullës + 1% kërkesë padive paraqitur në llog. 7112100 si të ardhura nga tarifat gjyqësore, në vlerën totale prej 503 125 lekë, Kjo vlerë është përdorur në masën 499 462 lekë për shpenzime për investime, dhe pjesa e të ardhurave të papërdorura nga rritja e autorizimeve pjesa e papërdorur nga çelja prej 3 663 lekë u derdh në buxhet gjithsej 3 663 lekë.

Të ardhurat e tjera nga njoftimet, fotokopje, sipas legjislacionit në fuqi kalojnë 100% në buxhetin e shtetit, pasi institucioni nuk përfiton si agjent tatimor nga këto të ardhura të cilat janë në shumën 43 473 lekë.

Nga të ardhurat e realizuara u krye blerje në shumën 499 462 lekë të cilat u përdorën pjesërisht për blerje printerash, sasia 3(tre) copë, pajisje të tjera si UPS SERVER sasia 1(një) copë, grila për zyrat, prozhektorë për sistemin e ndriçimit të jashtëm të godinës, si dhe rikonstrukcion i pjesshëm i zyrave dhe ambieteve nga ish-zyrat e Përmbarrimit Shtetëror, Zyra Vendore Gjirokastër.

7. Marrëdhëniet me institucionet e tjera.

- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me institucionet si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës me qëllim plotësimin e kërkesave dhe marrjen e masave për trajtimin e ankesave, kryerjen e procesit të hartimit dhe administrimit të statistikave dhe ndjekjen e trajnimit vazhduesh të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore. Edhe në vitin 2024 gjyqtarët kanë ndjekur trajnimet vazhduesh të organizuara kryesisht nga Shkolla e Magjistraturës.
- Në vitin 2024 janë zhvilluar disa takime dhe është rritur bashkëpunimi me institucionet si Komisaritet e Policisë dhe Bashkitë e Qarkut Gjirokastër, kryesisht për përmirësimin e procedurave që lidhen me plotësimin, paraqitjen dhe shqyrtimin e urdhrave të mbrojtjes, komunikimit sa më të shpejtë të vendimeve gjyqësore me qëllim zbatimin e menjëhershëm të tyre.
- Edhe në vitin 2024, është bërë e mundur përfaqësimi i viktimave me avokat falas në rastet kur e kërkojnë. Kjo në sajë të bashkëpunimit me Dhomën Vendore të Avokatisë Gjirokastër në bazë të listës së avokatëve që kanë pranuar të ofrojnë ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës në familje në gjykimet për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes. Po ashtu, është ndjekur praktika e mëparshme për përcaktimin e listës së avokatëve.

- Problematika e evidentuar më parë në lidhje me Dhomën e Avokatëve Gjirokastër, përse i përket përcaktimit të avokatëve të gatshëm për t'u caktuar si mbrojtës kryesisht në çështjet penale, nuk vazhdon pasi për vitin 2024 janë dërguar në mënyrë periodike lista apo grafiku përkatës.
- Në raport me organin e Prokurorisë bashkëpunimi vlerësohet shumë i mirë, pasi nuk janë shfaqur problematika që të çenojnë veprimtarinë e rregullt gjyqësore, në aspekte të respektimit të solemnitetit të gjykimit, mosparaqitjes në seancë apo paraqitjes me vonesë, në paraqitjen me vonesë të kërkesave urgjente për vlerësimin e arrestimeve në flagrancë, urdhrave të ndalimit, etj. Po ashtu, bashkëpunimi vlerësohet shumë i mirë, edhe me institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Është për t'u vlerësuar se ky institucion ka pranuar pa problem marrjen e njoftimeve qoftë edhe në formë elektronike, duke siguruar shoqërimin në kohë të personave, si dhe në mënyrë të sigurt.
- Me Policinë e Shtetit, përgjithësisht bashkëpunimi ka qenë shumë i mirë në lidhje me marrjen e masave nga ana e tyre për shoqërimin në kohë dhe në mënyrë të sigurt, të personave të arrestuar ose të ndaluar, njoftimin dhe kryerjen e detyrave të tjera në rastet e “Urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes”, etj.
- Në lidhje me shoqërinë “Posta Shqiptare” sh.a, siç u parashtrua më sipër, janë shfaqur problematika, në lidhje me cilësinë dhe shpejtësinë e ofrimit të shërbimit për realizimin e njoftimeve, por kemi një përmirësim në raport me vitin paraardhës.
- Gjatë vitit 2024, gjykata ka pasur një bashkëpunim të frytshëm edhe me Zyrën e Ndhmës Juridike Falas, e cila mbulon Qarkun Gjirokastër, duke bërë të mundur ofrimin e shërbimeve në hartimin e dokumentacionit dhe gjithë procedurave përkatëse për përfitimin e shërbimit të ndihmës juridike falas nga shtresat në nevojë.

V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Edhe pse mungojnë aktet normative që të përcaktojnë ngarkesën maksimale të çështjeve që mund të përballoj një gjyqtar, në mënyrë që të ushtroj normalisht funksionin, vlerësohet se gjatë këtij viti gjyqtarët kanë pasur një ngarkesë pune të lartë në raport me vitet paraardhëse. Rekomandojmë plotësimin dhe shtimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve, referuar organikës të Gjykatës së Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër prej 7 gjyqtarësh me qëllim që edhe ngarkesa e punës të jetë në vlera normale.

Edhe pse një pjesë e rëndësishme e ambienteve të gjykatës, të cilat nuk ishte në dispozicion të saj i janë kthyer Gjykatës së Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër nga Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor Gjirokastër, ish - Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër dhe nga Avokatura e Shtetit Gjirokastër, fakti që ambientet e ish-gjykatës Administrative dhe Avokaturës së Shtetit, sipas marrëveshjes së dakortësuar midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i kanë kaluar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, lind përsëri nevojën për shtim ambientesh, për të krijuar kushte të përshtatshme për mirëfunksionimin e kësaj gjykate.

I nevojshëm gjithashtu është edhe shtimi i sallave të gjykimit, nëse trupa gjykuese plotësohet me 7 gjyqtarë sipas organikës.

Prioriteti i kësaj gjykate do të jetë angazhimi i gjyqtareve dhe administratës së gjykatës për zbatimin e ligjit, dhënien e drejtësisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, me shpejtësi dhe transparencë në mënyrë **që drejtësia jo vetëm të bëhet, por edhe të duket** duke siguruar standartin më të lartë në garantimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve.

Dëshiroj të shpreh në emrin tim, të trupës gjyqësore dhe stafit të Gjykatës së Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër angazhimin tonë maksimal për rritjen në vijimësi të performancës së kësaj gjykate.

Gjirokastër, më 28/03/2025

ZËVENDËSKRYETARE E GJYKATËS

ENTE LA SELMANAJ